



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 480/ Prot

Tiranë, më 22 . 4 . 2022

VENDIM

Nr. 08, datë 22 . 4 . 2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, _____, përfaqësuar nga znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 480 Prot., datë 28.02.2022 (plotësuar me nr.480/2 Prot., datë 07.03.2022), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Banka e Shqipërisë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet shkresës datë 11.02.2022, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, për periudhën kohore që Banka e Shqipërisë ka përdorur hapësirat pranë Kompleksit Halili, Tiranë, në lidhje me:

1. *Datat e kontratave të qerasë që Banka e Shqipërisë ka nënshkruar për hapësirat që përdor në Kompleksin Halili, Tiranë.*
2. *Kopje të këtyre kontratave.*
3. *Kopje të dokumentave të prokurimit, nëse ka patur, për kontraktimin e qerasë.*
4. *Të dhënat mbi pagesat e qerave, duke përfshirë emrin e personit apo subjektit që ka përfituar pagesën, datat dhe vlerat e pagesave.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 480/3 prot., datë 08.03.2022 kërkoi të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1111/1 Prot., datë 16.03.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 480/4 Prot., datë 18.03.2022, ka sqaruar ndër të tjera se: *“...Bazuar në procedurat dhe politikat e brendshme të cilat lidhen me administrimin nuk e ka të mundur pranimin e kërkesës. Informacioni i kërkuar është i një natyre sensitive dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë jo informacion publik i kalsifikuar “sekret bankar/profesional”*.”

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga ana e Autoritetit Publik, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore.

Për shkak të nevojës së zhvillimit të një seance dëgjimore, Komisioneri, bazuar në nenet 53, 91 dhe 92 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 480/6 Prot., datë 31.03.2022 “Për zgjatjen e afatit të procedurës administrative”, vendosi shtryrjen e afatit të përfundimit të procedurës deri me datë 22.04.2022.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë, duke kërkuar nga Autoriteti Publik, t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni i kërkuar që ky i fundit e zotëron. Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër, si dhe sqaruan ndër të tjera se: *“...Neni 76, i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përjashton Bankën e Shqipërisë si subjekt i dispozitave të “Ligjit për prokurimet publike”*.”

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe zhvillimit të seancës dëgjimore, Komisioneri vlerëson se argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: *“Informacioni i kërkuar është i një natyre sensitive dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë informacion jo publik, i klasifikuar “sekret bankar/profesional”*, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron, pasi terminologjia *“Sekret Bankar”* e përdorur nga Autoriteti Publik nuk gjen rregullim të posaçëm në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 *“Për Bankën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, si dhe në gjithë kuadrin nënligjor të dalë në zbatim të tij.

Gjithashtu, në nenin 2 të rregullores *“Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”*, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 81, datë 15.11.2006, i ndryshuar parashikohen parimet kryesore mbi bazën e të cilave kryhen procedurat e prokurimit nga Autoriteti Publik. Në pikën “d” të këtij neni parashikohet *“parimi i sigurimit të ndershmërisë, besimit të publikut dhe të arritjes së transparencës në procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”*.

Gjatë procesit të hetimit administrativ Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Në pikën 6 të këtij neni, parashikohet se: *“...Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim.”*. Bazuar në këtë parashikim, Autoriteti Publik duhet të kishte vlerësuar individualisht çdo pikë të kërkesës për informacion, duke provuar dhe argumentuar mbi cilën pikë të nenit 17 bazohet kufizimi i informacionit, vlerësim i cili nuk rezulton të jetë bërë.

Për rrjedhojë, Autoriteti Publik nuk mund të bazojë kufizimin e një të drejte kushtetuese, vetëm mbi argumentin se *Informacioni i kërkuar është i një natyre sensitive dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë informacion jo publik, i klasifikuar “sekret bankar/profesional”*.

Lidhur me pretendimin e dhënë nga përfaqësuesit e Autoritetit Publik gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore se: *“...Neni 76, i Ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përjashton Bankën e Shqipërisë si subjekt i dispozitave të “Ligjit për prokurimet publike”*, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht legjislacionit të aplikueshëm për zhvillimin e procedurave të kontraktimit, si dhe përjashtimit të Autoritetit Publik nga zbatimi i Ligjit për prokurimin publik, ky fakt nuk passjell përjashtimin e këtij autoriteti nga zbatimi i LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*. Në kuptim të këtij parashikimi, Banka e Shqipërisë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Nga shqyrtimi i objektit të kërkesës për informacion, Komisioneri konstaton se, një pjesë e informacionit të kërkuar në pikën 1 dhe 4 të kërkesës për informacion përfshihet në kategorinë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, bazuar kjo në shkronjat e) dhe ë) të pikës 1 të nenit 7 të LDI, në të cilën parashikohet se: *“1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara; ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme”. Detyrim ky i cili nuk rezulton i përmbushur nga Autoriteti Publik.*

Ndërkohë, pikat 2 dhe 3 të kërkesës për informacion përfshihen në kategorinë e informacioneve që në kuptim të LDI, mund të vendoset në dispozicion nga Autoriteti Publik vetëm mbi bazën e një kërkesë.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo zotërohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.*

Gjithashtu, kërkesja/ankuesja është gazetare, e cila synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik.

Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e

krijua, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikqyrësit shoqërorë”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përfundimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

E drejta për informim, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t’i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”*.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 480 Prot., datë 28.02.2022, të _____ përfaqësuar nga znj. _____ kundër Autoritetit Publik “Banka e Shqipërisë”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 11.02.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: *(1. Datat e kontratave të qerasë që Banka e Shqipërisë ka nënshkruar për hapësirat që përdor në Kompleksin Halili, Tiranë. 2. Kopje të këtyre kontratave. 3. Kopje të dokumentave të prokurimit, nëse ka patur, për kontraktimin e qerasë. 4. Të dhënat mbi pagesat e qerave, duke përfshirë emrin e personit apo subjektit që ka përfituar pagesën, datat dhe vlerat e pagesave.)*, brenda datës 04 . 5 .2022.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e tij, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 22. 4 .2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

